

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE

Nr. 32548

32548

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM

Sot, me date 10/12 2004, unë M. Mulla, gjyqtare prane kësaj gjykate, pasi studjova kerkesen dhe dokumentacionin e paraqitur nga Z. Alban Çausi, ne cilësinë e perfaqesuesit të autorizuar të shoqërisë "Trans-European Energy B.V "Sh.A,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria "TRANS-EUROPEAN ENERGY B.V., SH.A.", person juridik i së drejtës shqiptare, themelohet nga aksioneri i saj i vetëm: Trans-European Energy B.V., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas së drejtës hollandeze, me seli në Amsterdam, Hollandë dhe adresë: Amsteldijk 166-6, 1079 LH Amsterdam, Hollandë.

Shoqëria "TRANS-EUROPEAN ENERGY B.V., SH.A." do të ketë formën e shoqërisë anonime.

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Bulevardi "Zhan D'Ark", Kulla 3, Ap.2/1, Tiranë, Shqipëri.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të përfshijë kryesisht:

- Import, eksport, tregëti me shumicë, transport të: gazit, naftë, naftë e papërpunuar, lëndë djegëse, bitum, gaz i lëngshëm për përdorim shtëpiak dhe industrial, vaj lubrifikant, produkte speciale;
- ndërtim i depozitave të naftës, lëndëve djegëse, gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikantë;
- ndërtimi dhe ngritja e pikave për mbushjen e gazit të lëngshëm;
- ndërtimi dhe instalimi i depozitave të gazit të lëngshëm përdorim shtëpiak dhe industrial;
- pika karburanti private apo shtetërore me ngjyra dhe markë ekskluzive për furnizimin e nënprodukteve të naftës;
- ndërtimi i hoteleve, restoranteve, serviseve të makinave e garazheve të lidhura drejtpërdrejt me serviset e makinave;
- lidhja e marrëveshjeve dhe/ose kontratave me subjekte, persona fizikë apo juridikë, rezidentë në RSh apo vende të tjera, për realizimin e qëllimit të shoqërisë;
- blerja dhe shitja e pasurisë së paluajtshme;

- çdo veprim tjetër financiar apo tregëtar i nevojshëm për ushtrimin e objektit.

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është 30 vjet.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 2.000.000 (dy milionë) lekë. Kapitali ndahet në 2000 (njëqind) pjesë, me vlerë nominale 1000 (një mijë) lekë secila. Pjesët e kapitalit zotërohen 100% nga aksioneri "TRANS-EUROPEAN ENERGY B.V., SH.A."

Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë është Z. Edmondo Falcione, lindur më 28 Shtator 1961, në Campobasso, Itali, banues në Via Gorizia 42, 88100, mbajtës i pashportës me nr. 089764.

PER KETO ARSYE:

Ne baze të ligjit Nr. 7638, 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", dhe Ligjin Nr. 7667, date 28.01.1993, "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqerite tregtare",

VENDOSA:

- Pranimin e Kerkeses;
- Regjistrimin e shoqërisë "Tran-European Energy B.V" Sh.A si person juridik.
- Shoqëria "TRANS-EUROPEAN ENERGY B.V., SH.A." do të ketë formën e shoqërisë anonime.
- Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Bulevardi "Zhan D'Ark", Kulla 3, Ap.2/1, Tiranë, Shqipëri.
- Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të përfshijë kryesisht:
 - Import, eksport, tregëti me shumicë, transport të: gazit, naftë, naftë e papërpunuar, lëndë djegëse, bitum, gaz i lëngshëm për përdorim shtëpiak dhe industrial, vaj lubrifikant, produkte speciale;
 - ndërtim i depozitave të naftës, lëndëve djegëse, gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikantë;
 - ndërtimi dhe ngritja e pikave për mbushjen e gazit të lëngshëm;
 - ndërtimi dhe instalimi i depozitave të gazit të lëngshëm përdorim shtëpiak dhe industrial;
 - pika karburanti private apo shtetërore me ngjyra dhe markë ekskluzive për furnizimin e nënprodukteve të naftës;
 - ndërtimi i hoteleve, restoranteve, serviseve të makinave e garazheve të lidhura drejpërdrejt me serviset e makinave;


- lidhja e marrëveshjeve dhe/ose kontratave me subjekte, persona fizikë apo juridikë, rezidentë në RSh apo vende të tjera, për realizimin e qëllimit të shoqërisë;
- blerja dhe shitja e pasurisë së paluajtshme;
- çdo veprim tjetër financiar apo tregëtar i nevojshëm për ushtrimin e objektit.

- Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është 30 vjet.

- Kapitali themeltar i shoqërisë është 2.000.000 (dy milionë) lekë. Kapitali ndahet në 2000 (njëqind) pjesë, me vlerë nominale 1000 (një mijë) lekë secila. Pjesët e kapitalit zotërohen 100% nga aksioneri "TRANS-EUROPEAN ENERGY B.V., S.H.A."

- Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë është Z. Edmondo Falcione, lindur më 28 Shtator 1961, në Campobasso , Itali, banues në Via Gorizia 42, 88100, mbajtës i pashaportës me nr. 089764.

Kundër këtij vendimi mund të behet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

GJYQTARE


AKT THEMELIMI I SHOQËRISE
TRANS-EUROPEAN ENERGY B.V., SH.A



Shoqëria TRANS-EUROPEAN ENERGY B.V., SH.A themelohet në përputhje me këtë Akt Themelimi, Statutin si dhe ligjin shqiptar “Për shoqëritë Tregtare” nga aksioneri i vetëm:

1. Trans-European Energy B.V, person juridik i së drejtës hollandeze, me seli në Amsterdam, Hollandë, Amsteldijk 166-6, 1079 LH, regjistruar pranë Dhomës së Tregëtisë të Amsterdimit nr.34190831, përfaqësuar ligjërisht për regjistrimin e shoqërisë Trans-European Energy B.V Sh.A nga Z.Alban Çaushti, sipas vendimit të Bordit Drejtues të shoqërisë, datë 26 Nëntor 2004.

Neni 1
Forma Ligjore

1. Shoqëria krijohet në formën e shoqërisë anonime në bazë të ligjit Shqiptar “Për Shoqëritë Tregtare”.

Neni 2
Selia

- 2.1 Selia e shoqërisë është në adresën Rruga Bulevardi “Zhan D’Ark, Kulla 3, Ap.2/1, Tirana, Albania.
- 2.2 Shoqëria e ushtron veprimtarinë e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ajo mund të hapë zyra, filiale, agjenci ose të ofrojë shërbime në gjithë territorin e vendit me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve.

Neni 3
Emertimi

- 3.1 Emri i shoqërisë është TRANS-EUROPEAN ENERGY B.V., SH.A

Neni 4
Kohëzgjatja

- 4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë është 30 (tridhjetë) vjet, duke filluar që nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Gjykatën e Rrethit Tiranë.
- 4.2 Shoqëria mund të përfundojë para këtij afati ose ta zgjasë këtë afat me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve, në përputhje me ligjin shqiptar.

Neni 5 Objekti

5.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Import, eksport, tregëti me shumicë, transport të: gazit, naftë, naftë e papërpunuar, lëndë djegëse, bitum, gaz i lëngshëm për përdorim shtëpiak dhe industrial, vaj lubrifikant, produkte speciale;
- ndërtim i depozitave të naftës, lëndëve djegëse, gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikantë;
- ndërtimi dhe ngritja e pikave për mbushjen e gazit të lëngshëm;
- ndërtimi dhe instalimi i depozitave të gazit të lëngshëm përdorim shtëpiak dhe industrial;
- pika karburanti private apo shtetërore me ngjyra dhe markë ekskluzive për furnizimin e nënprodukteve të naftës;
- ndërtimi i hoteleve, restoranteve, serviseve të makinave e garazheve të lidhura drejtpërdrejt me serviset e makinave;
- lidhja e marrëveshjeve dhe/ose kontratave me subjekte, persona fizikë apo juridikë, rezidentë në RSh apo vende të tjera, për realizimin e qëllimit të shoqërisë;
- blerja dhe shitja e pasurisë së paluajtshme;
- çdo veprim tjetër financiar apo tregëtar i nevojshëm për ushtrimin e objektit.

5.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose shtohet me vendim të Asmablesë së Përgjithshme të Aksionerëve.

5.3 Shoqëria mund të ushtrojë veprimtari të tjera plotësuese që janë të dobishme ose të nevojshme për realizimin e objektit të saj, në përputhje me ligjin shqiptar.

5.4 Shoqëria do të bashkëpunojë me persona të tjerë fizikë ose juridikë që ushtrojnë të njëjtën veprimtari në Shqipëri ose jashtë saj.

Neni 6 Kontributet

6.1 Në çastin e krijimit të shoqërisë, kapitali themeltar i shlyer në lekë është 2 000 000 (dy milion).

6.2 Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 2 000 aksione që kanë një vlerë nominale prej 1000 (një mijë) lekë secili. Aksionet janë të pandashme.

6.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht prej aksionerit.

Neni 7 Organet e Shoqërisë

7.1 Organet e shoqërisë janë:

Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve, që është organi më i lartë i shoqërisë.

Këshilli Mbikqyrës që është organi që administroon shoqërinë. Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga:

1. Edmundo Falcione (kryetar)
2. Umberto Tucci (anetar)
3. Anduena Pustina (anetar)

Drejtoria e cila administroon veprimtarinë e shoqërisë. Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë është z. Edmundo Falcione

Neni 8 Viti Financiar

8.1 Viti financiar ka një kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke filluar që nga data 1 Janar deri në datën 31 Dhjetor, me përjashtim të vitit të parë i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në gjykatë dhe mbaron në 31 Dhjetor 2004.

8.2 Këshilli Mbikqyrës mbikqyr llogaritë vjetore që të jenë në përputhje me ligjin "Për Kontabilitetin" dhe harton raportin mbi administrimin.


Neni 9 Dividendët

9.1 Pas miratimit të bilancit vjetor dhe llogarotjen e shumës që do të ndahet, Asambleja e Përgjithshme përcakton shumën që do tu jepet aksionerëve si dividend në bazë të neneve 215, 216 të ligjit të shoqërive.

Neni 10 Dispozita të Përgjithshme

10.1 Ky statut është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.

**AKSIONERI
Trans-European Energy B.V, Sh.A**

Alban Cushi


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

NR. 5764 REP.


NR. 2006 KOL.

VËRTETIM

Sot më datë 7 Dhjetor 2004 para meje Arjana Mallkuçi, notere e Dhomës së Notereve Tiranë, u paraqit personalisht Z. Alban Caushi, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 25 Mars 1973, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër QH 328197, i cili në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë "TRANS-EUROPEAN ENERGY B.V., SH.A." me anë të vendimit të Bordit të Drejtorëve të kësaj shoqërie, date 26 Nëntor 2004, më paraqiti këtë Akt Themelimi dhe pasi e nënshkroi atë rregullisht para meje, unë noterja e vërtetoj nënshkrimin e tij sipas ligjit.

NOTERE

NOTERE
ARJANA R. MALLKUÇI
Tel. Zyre 250253, 266242



STATUT I SHOQËRISE
“TRANS-EUROPEAN ENERGY B.V“ SH.A



Shoqëria TRANS-EUROPEAN ENERGY B.V., SH.A themelohet në përputhje me këtë statut dhe Aktin e themelimit nga aksioneri i vetëm mëposhtëm:

1.Trans-European Energy B.V, person juridik i së drejtës hollandeze, me seli në Amsteldijk 166-6, 1079 LH Amsterdam, Hollandë, regjistruar pranë Dhomës së Tregëtisë të Amsterdamit nr.34190831,

e përfaqësuar ligjërisht për regjistrimin e shoqërisë Trans-European Energy B.V Sh.A nga Z.Alban Çaushti, sipas vendimit të Bordit Drejtues të shoqërisë, datë 26 Nëntor 2004.

KAPITULLI I
KRIJIMI - FORMA — EMRI
SELIA - KOHËZGJATJA - OBJEKTI

Neni 1
Aksionerët Themelues

Aksioneri themelues i shoqërisë është:

Trans-European Energy B.V, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të shtetit të Hollandës, me seli në Amsterdam, Amsteldijk 166-6, 1079 LH, Hollandë, regjistruar pranë Dhomës së Tregëtisë të Amsterdamit nr.34190831

Neni 2
Forma Ligjore

Shoqëria krijohet në formën e shoqërisë anonime në bazë të ligjit Shqiptar “Për Shoqëritë Tregtare”

Neni 3
Emri

Emri i shoqërisë është “TRANS-EUROPEAN ENERGY B.V., SH.A.”

Neni 4
Selia

Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga Bulevardi “Zhan D’Ark, Kulla 3, Ap.2/1, Tirana, Albania.

Shoqëria e ushtron veprimtarinë e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ajo mund të hapë zyra, filiale, agjenci ose të ofrojë shërbime në gjithë territorin e vendit me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve.

Neni 5 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është 30 (pesëdhjetë) vjet, duke filluar që nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Shoqëria mund të përfundojë para këtij afati ose ta zgjasë këtë afat me vendim të Asamblesë së Aksionerëve/Aksioneri i Vetem, në përputhje me ligjin shqiptar.

Neni 6 Objekti

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Import, eksport, tregëti me shumicë, transport të: gazit, naftë, naftë e papërpunuar, lëndë djegëse, bitum, gaz i lëngshëm për përdorim shtëpiak dhe industrial, vaj lubrifikant, produkte speciale;
- ndërtim i depozitave të naftës, lëndëve djegëse, gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikantë;
- ndërtimi dhe ngritja e pikave për mbushjen e gazit të lëngshëm;
- ndërtimi dhe instalimi i depozitave të gazit të lëngshëm përdorim shtëpiak dhe industrial;
- pika karburanti private apo shtetërore me ngjyra dhe markë ekskluzive për furnizimin e nënprodukteve të naftës;
- ndërtimi i hoteleve, restoranteve, serviseve të makinave e garazheve të lidhura drejtpërdrejt me serviset e makinave;
- lidhja e marrëveshjeve dhe/ose kontratave me subjekte, persona fizikë apo juridikë, rezidentë në RSh apo vende të tjera, për realizimin e qëllimit të shoqërisë;
- blerja dhe shitja e pasurisë së paluajtshme;
- çdo veprim tjetër financiar apo tregëtar i nevojshëm për ushtrimin e objektit.

Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose shtohet me vendim të Asamblesë së Aksionerëve/Aksioneri i Vetem.

Shoqëria mund të ushtrojë veprimtari të tjera plotësuese që janë të dobishme ose të nevojshme për realizimin e objektit të saj, në përputhje me ligjin shqiptar.

Shoqëria do të bashkëpunojë me persona të tjerë fizikë ose juridikë që ushtrojnë të njëjtën veprimtari në Shqipëri ose jashtë saj.

KAPITULLI II KAPITALI – AKSIONET

Neni 7 Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 2 000 000 (dy milion) Leke.

Kapitali është i ndarë në 2 000 aksione që kanë një vlerë nominale prej 1000 (një mijë) leke secili. Aksionet janë të pandashme.

Aksioneri i Vetëm ka nënshkruar dhe shlyer tërësisht aksionet si vijon:

“TRANS-EUROPEAN ENERGY B.V. zotëron 2.000 aksione (100% të aksioneve) që i korrespondojnë vlerës 2.000.000 Lekë (dy milionë lekë).

Neni 8 Zmadhimi i Kapitalit

Kapitali themeltar zmadhohet vetëm me vendim të Asamblesë së Aksionerëve/Aksioneri I Vetëm, mbi bazën e raportit të Drejtorisë. Statuti i shoqërisë ndryshohet në përputhje me këtë rritje.

Kapitali mund të rritet nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja ose nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistuese. Aksionet e reja shlyhen më para në dorë ose me kontribut në natyrë.

Aksionerët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrimin e aksioneve për rritjen e kapitalit. E drejta e përparësisë ushtrohet në raport me aksionet që zotëron çdo aksioner në çastin e rritjes së kapitalit. Aksionerët mund të heqin dorë personalisht nga e drejta e nënshkrimit të aksioneve të reja.

Në rastin e rritjes së kapitalit me kontribute në natyrë, me vendim gjykatë caktohet një ekspert për kontributet në përputhje me nenet 162, 168, 169 të ligjit të shoqërive.

Rritja e kapitalit duhet të përfundojë brenda 5 (pesë) vjetëve nga data e Asamblesës së Aksionerëve/Aksioneri i Vetëm, që ka marrë një vendim të tillë (neni 153 i ligjit të shoqërive).

Neni 9 Zvogëlimi i Kapitalit

Zvogëlimi i kapitalit vendoset nga Asambleja e Aksionerëve/Aksioneri i Vetëm, por në një rast të tillë zvogëlimi i prek të gjithë aksionerët proporcionalisht me aksionet që zotërojnë në shoqëri në bazë të nenit 164 ligjit të shoqërive.



Drejtoria i dorëzon Asamblesë së mbledhur për marrjen e një vendimi mbi zvogëlimin e kapitalit një raport të arsyetuar i cili përshkruan rrethanat që kanë bërë të detyrueshme zvogëlimin e kapitalit.

Zvogëlimi i kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar të paktën 45 (dyzetë e pesë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë së Aksionereve/Aksioneri i Vetem, që thirret për të vendosur mbi zvogëlimin e kapitalit.

Neni 10 **Shlyerja dhe Verifikimi i Kapitalit**

Kapitali themeltar i shoqërisë duhet të jetë shlyer plotësisht, në qoftë se realizohet zmadhimi i kapitalit aksioner me para në dorë. Në rast të kundërt, rritja e kapitalit dhe emetimi i aksioneve të reja konsiderohen të pavlefshme sipas nenit 154 të ligjit të shoqërive.

Në rast të rritjes së kapitalit, Këshilli Mbikqyrës duhet që brenda një afati 3 (muajor) nga zmadhimi i kapitalit të verifikojë depozitimimin e kapitalit.

Neni 11 **Aksionet**

Aksionet janë nominale. Për aksionet do të lëshohen tituj transferimi në bazë të ligjit, tipi i të cilave vendoset nga Këshilli Mbikqyrës i cili përcakton personat që do të firmosin titujt. Aksionet nonimale u transferohen të tretëve në bazë të nenit 198 të ligjit të shoqërive. Në çastin e themelimit të shoqërisë ose gjatë ekzistencës së saj, shoqëria mund të emetojë aksione me përparësi të cilat kanë avantazhe në raport me gjithë aksionet e tjera, sipas nenit 148, 149 të ligjit të shoqërive.

Aksionet janë të pandashme. Ato kanë vetëm një pronar kryesor. Çdo aksion jep të drejtën e një vote. Në rast se një aksion zotërohet nga më shumë se një pronar, atëherë të drejtat e tyre ushtrohen nga një përfaqësues, në të kundërt, aksioni nuk përfaqësohet dhe ushtrimi i të drejtave që vijnë si pasojë e tij pezullohet.

Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga çdo aksion i ushtron vetëm prurësi i ligjshëm.

Neni 12 **Transferimi i Aksioneve**

Në rastin kur një aksioner dëshiron të transferojë të gjitha ose një pjesë të aksioneve të tij, është i detyruar të njoftojë me shkrim Këshillin Mbikqyrës, duke i bërë të ditur vlerën e aksioneve me qëllim që aksionerët e tjerë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes. Këshilli Mbikqyrës njofton me shkrim aksionerët e tjerë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së njoftimit për një transferim të tillë.

Aksionerët e tjerë duhet të njoftojnë Këshillin Mbikqyrës brenda 3 (tre) muajve nëse ata do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes apo jo.



Në rast se numri i aksionerëve që dëshirojnë të blejnë aksione është më i madh se një, ata do të marrin aksione në përpjesëtim me numrin e aksioneve që zotërojnë. Transferimi i aksioneve në ndryshim me sa është parashikuar në këtë nen do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të prodhojë efekte ligjore për shoqërinë.

Neni 13 **Të Drejtat dhe Detyrimet që lidhen me Aksionet**

Çdo aksion i jep të drejtën zotëruesit të tij të marrë pjesë në fitimet e shoqërisë në raport me aksionet që ai/ajo përfaqëson dhe në rast likuidimi të drejtën e pjesëmarrjes në asetet e mbetura të shoqërisë.

Aksionerët janë përgjegjës deri në vlerën nominale të aksioneve të tyre.

Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga aksionet ndjekin aksionet pavarësisht nga transferimi i tyre.

KAPITULLI III **ORGANET KOMPETENTE**

Neni 14 **Asambleja e Aksionerëve/Aksioneri i Vetëm**

Asambleja e Aksionerëve/Aksionerit të Vetëm është organi më i lartë i shoqërisë. Ajo vendos për çdo problem dhe vendimet e saj janë të detyrueshme për çdo aksioner.

Neni 15 **Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme e Aksionerëve**

Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme e Aksionerëve ka të drejtë të marrë çdo vendim përveç atyre të parashikuara në nenin 128 të Ligjit të Shoqërive Tregtare të cilat janë në diskrecion të Asamblesë së Jashtëzakonshme së Aksionerëve.

Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme e Aksionerëve merr çdo vendim përfundimtar për çështjet që kanë lidhje me shoqërinë. Vendimet e saj janë të vlefshme në qoftë se në mbledhjen e parë marrin pjesë personalisht ose me prokurë aksionerë të cilët zotërojnë të paktën $\frac{1}{4}$ e kapitalit aksioner me të drejtë vote. Në rastet kur mbledhja do të shtyhet në mbledhjen e dytë nuk nevojitet quorumi.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme së Aksionerëve merren me shumicë të thjeshtë votash të aksionerëve të pranishëm.

Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme e Aksionerëve mbledhet të paktën një herë në vit brenda gjashtë muajve pas mbylljes së vitit financiar. Ky afat mund të zgjatet me vendim gjykatë.

Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme e Aksionerëve analizon dhe vendos për të gjitha çështjet që kanë lidhje me vitin e fundit financiar, në përputhje me parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Paragrafi 2 dhe 3 më lart nuk zbatohen në rastin kur shoqëria ka një aksioner të vetëm.

Neni 16

Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme e Aksionerëve

Ndryshimet e Statutit të shoqërisë janë e drejtë vetëm e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Aksionerëve/Aksionerit të Vetëm.

Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të marrë vendime vetëm në qoftë se në mbledhjen e parë janë të pranishëm personalisht ose me përkurë aksionerët të cilët përfaqësojnë (zotërojnë) të paktën $\frac{1}{2}$ e kapitalit aksioner më të drejtë vote dhe në mbledhjen e dytë $\frac{1}{4}$ e kapitalit aksioner. Në qoftë se mbledhja e parë shtyhet atëherë mbledhja e dytë duhet të mbledhet brenda dy muajve nga data e mbledhjes së parë.

Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve merr vendime me shumicë absolute, d.m.th. $\frac{3}{4}$ e votave të aksionerëve të pranishëm apo të përfaqësuar.

Paragrafi 12 dhe 3 më lart nuk zbatohen në rastin kur shoqëria ka një aksioner të vetëm.

Neni 17

Modalitetet e Thirrjes

Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve thirret nga Këshilli Mbikqyrës ose Drejtoria. Në mungesë të tyre, mund të thirret nga:

- 1) Eksperti Kontabël i Autorizuar;
- 2) Personi i autorizuar nga gjykata mbi kërkesën e çdo të interesuari në një rast urgjent ose të një ose disa aksionerëve që së bashku zotërojnë $\frac{1}{10}$ e kapitalit;
- 3) Likuidatori;

Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve thirret në mënyrën e parashikuar nga ligji.

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve mbahen në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër në territorin e Shqipërisë ose jashtë saj.

Neni 18

Vlefshmëria e Vendimeve

Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve merr vendime të vlefshme edhe kur procedurat e thirrjes nuk janë respektuar, në qoftë se të gjithë aksionerët janë prezent ose të përfaqësuar. Personi që thërret mbledhjen përgatit rendin e ditës së Asamblesë së Aksionerëve. Njoftimi për shtyrjen e mbledhjes nuk mund ta ndryshojë rendin e ditës.

Nje aksioner mund të përfaqësohet vetëm nga një aksioner tjetër ose nga bashkëshorti ose bashkëshortja.

Neni 19 E Drejta e Informimit

Drejtorja është e detyruar të vërë në dispozicion të aksionerëve përpara mbledhjes së Asamblesë, të gjitha dokumentet që parashikon ligji i shoqërive.

Çdo aksioner ose përfaqësuesi i tij ka të drejtën të marrë informacion mbi të gjitha çështjet e parashikuara në ligjin e shoqërive, në selinë e tyre, duke filluar nga momenti i marrjes njoftim i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve. Në mënyrë të veçantë, ata kanë të drejtën për të marrin informacion për:

- regjistrat, bilancet, listat e antarëve të Drejtorisë dhe të Këshillit Mbikqyrës;
- raportet e Drejtorisë, të Këshillit Mbikqyrës dhe Ekspertit Kontabël të autorizuar;
- shumën e saktë të shpërblimeve të personave të mësipërm.

Çdo aksioner ka të drejtën të marrë informacion ose kopje të listës së aksionerëve dhe antarëve të Këshillit Mbikqyrës 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë.

Nëse shkelet e drejta për të marrë informacion e aksionerëve, ata kanë të drejtën t'i drejtohen gjykatës.

Neni 20 Kërkesa për të Marrë pjesë në Mbledhje

Aksionerët që duan të marrin pjesë në Asamblenë e Prgjithshme duhet të dorëzojnë aksionet e tyre ose një certifikatë bankare të depozitimit të aksioneve pranë një banke.

Neni 21 Përfaqësimi në rastet e aksioneve të përbashkëta

Në rast se një aksion mbahet nga më shumë se një person, ata duhet të caktojnë një përfaqësues i cili ka të drejtën të ushtrojë të drejtat e aksionerëve.

Neni 22 Pjesëmarrës të Tjerë

Antarët e Këshillit Mbikqyrës, të Drejtorisë dhe eksperti kontabël mund të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve dhe kanë vota konsultative. Nëse ata janë aksionerë, vota e tyre është vendosëse.

Neni 23 Librat

Emrat e atyre që marrin pjesë në Asambletë e Përgjithshme të Aksionerëve regjistrohen në "Librin e Pjesëmarrësve".

Për mbledhjet mbahet procesverbal.

Neni 24
Kryetari i Këshillit Mbikqyrës

Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve drejtohet nga Kryetari i Këshillit Mbikqyrës ose në mungesë të tij nga zëvendësi i tij ose nga një person i zgjedhur nga antarët e pranishëm.

Neni 25
Të Drejtat e Minorancës

Aksionerët që zotërojnë 1/10 e kapitalit aksioner mund të thërrasin Asamblenë e Jashtëzakonshme të Aksionerëve duke përcaktuar dhe rendin e ditës. Këshilli Mbikqyrës është i detyruar ta thërrasë Asamblenë e Jashtëzakonshme të Aksionerëve kur kërkohet, përveç rastit kur ekziston një arsye e rëndësishme. Aksionerët që zotërojnë 1/10 e kapitalit aksioner mund t'i drejtohen gjykatës për ekzistencën e arsyes së rëndësishme dhe të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme.

Aksionerët që zotërojnë 1/10 e kapitalit aksioner mund të kërkojnë nga Kryetari i Asamblesë të pezullojë marrjen e një vendimi nga Asambleja e Zakonshme ose e Jashtëzakonshme vetëm një herë, duke përcaktuar ditën e mbledhjes tjetër e cila nuk duhet të kalojë 30 (tridhjetë) ditë nga dita e pezullimit të mbledhjes së parë.

Neni 26
Këshilli Mbikqyrës

Këshilli Mbikqyrës është organi që drejton shoqërinë. Ai përbëhet nga 3 (tre) antarë të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës janë:

- | | |
|---------------------|-----------|
| 1. Edmondo Falcione | (kryetar) |
| 2. Umberto Tucci | (anëtar) |
| 3. Anduena Pustina | (anëtar) |

Antarët e Këshillit Mbikqyrës të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme mund të mos jenë të punësuar në shoqëri.

Neni 27
Antarët

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës mund të mos jenë aksionerë. Antarët e Këshillit Mbikqyrës nuk kanë përgjegjësi personale kundrejt të tretëve dhe aksionerëve të shoqërisë. Ata mbajnë përgjegjësi kundrejt shoqërisë për detyrat që u janë ngaruar.

Antarët e Këshillit Mbikqyrës qëndrojnë në detyrë për një periudhë prej 2 vjetësh e cila mund të përtërihet dhe për një periudhë tjetër me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të thirrur për miratimin e deklaratave financiare të vitit financiar që u mbyll.

Këshilli Mbikqyrës cakton një kryetar dhe zëvendësin e tij. Kryetari dhe në mungesë të tij zëvendësi, drejton mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës.

Në rast vdekjeje, largimi ose mungese të paarsyeshme nga tre mbledhje të njëpasnjëshme, Këshilli Mbikqyrës mund të emërojë një zëvendës deri në mbledhjen e ardhshme të Asamblesë së Aksionerëve.

Neni 28 Mbledhjet

Këshilli Mbikqyrës mbledhet nga Kryetari ose në mungesë të tij nga zëvendësi, ose në rast të tjera nga të paktën 2 (dy) antarë të tij.

Këshilli Mbikqyrës merr vendime me shumicën e thjeshtë të votave të antarëve të tij të pranishëm.

Këshilli Mbikqyrës ka një shumicë dhe mbledhet ligjërisht kur janë të pranishëm ose të përfaqësuar 50 për qind plus një e antarëve të tij. Antarët që mungojnë nga Këshilli Mbikqyrës mund të përfaqësohen vetëm nga një antar tjetër i Këshillit Mbikqyrës.

Neni 29 Vendimet

Diskutimet dhe vendimet e Këshillit Mbikqyrës mbahen në procesverbale të cilat firmosen nga antarët e pranishëm së bashku me mendimet e kundërta të atyre që nuk janë dakord.

Këshilli Mbikqyrës ka kompetencën të vendosë për të gjitha çështjet e drejtimit të shoqërisë, administrimit e pasurive të saj dhe realizimin e qëllimeve të shoqërisë. Këshilli mbikqyrës nuk ka të drejtë të vendosë për çështje për të cilat janë në kompetencë të Asamblesë së Aksionerëve.

Këshilli Mbikqyrës mund të delegojë me shkrim përfaqësimin e shoqërisë dhe/ose të kompetencave të saj tek një ose disa antarë ose palë të treta, duke përcaktuar dhe kompetencat e deleguara.

Antarët e Këshillit Mbikqyrës përfitojnë shpërblim i cili vendoset nga Asambleja e Aksionerëve.

Neni 30 Drejtoria

Antarët e Drejtorisë emërohen nga Këshilli Mbikqyrës.



Antarët e Drejtorisë mund të mos jenë aksionerë në shoqëri dhe nuk duhet të jenë antarë të Këshillit Mbikqyrës.

Antarët e Drejtorise janë persona fizikë.

Drejtori i parë i zgjedhur për shoqërinë është Z. Edmundo Falcione. I njëjti edhe Drejor i Përgjithshëm i shoqërisë

Neni 31 **Mandati i Antarëve të Drejtorisë**

Antarët e Drejtorisë qëndrojnë në detyrë për një periudhë prej 2 vjetësh (nga 2 deri në 6 vjet).

Në rast të vendeve vakante, plotësimi duhet të bëhet brenda 2 muajve. Nëse plotësohet vendi vakant, zëvendësi qëndron në detyrë deri në emërimin e një Drejtorise së re.

Këshilli Mbikqyrës për shkaqe të arsyeshme mund të shkarkojë antarët e Drejtorisë.

Neni 32 **Funksionimi**

Antarët e Drejtorisë mund t'i ndajnë detyrat e tyre duke patur miratimin paraprak të Këshillit Mbikqyrës. Drejtoria duhet të informohet periodikisht për vendimet e antarëve të saj.

Drejtoria në marrëdhënie me palët e treta përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 33 **Mbledhjet e Drejtorisë**

Drejtoria mbledhet në çdo kohë që e kërkon interesi i shoqërisë. Mbledhjet e Drejtorisë thirren nga Drejtori i Përgjithshëm ose nga një prej drejtorëve të tjerë. Njoftimi bëhet me shkrim me postë, e-mail, faks, telefaks, teleks ose në ndonjë mënyrë tjetër.

Mbledhjet mbahen në selinë e shoqërisë dhe drejtohen nga Drejtori i Përgjithshëm ose drejtori që thërret mbledhjen.

Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave. Nuk lejohet votimi nëpërmjet përfaqësuesve.

Neni 34 **Kompetencat**

Drejtoria ka kompetenca të plota për të vepruar në çdo rrethanë në emër të shoqërisë, me kusht që këto kompetenca nuk janë në diskrecionin e Asamblesë së Përgjithshme ose Këshillit Mbikqyrës.

Drejtoria ushtron kompetencat e saj brenda kufijve të objektit të shoqërisë.



Në rast të transaksioneve që kërkojnë autorizimin e Këshillit Mbikqyrës dhe ky i fundit nuk e jep atë, Drejtoria mund të thërrasë Asambleshën e Përgjithshme dhe t'ia paraqesë çështjen për shqyrtim.

Drejtoria përgatit raportet dhe rendin e ditës së mbledhjeve të Asamblesës së Përgjithshme dhe Këshillit Mbikqyrës.

Drejtoria, brenda 3 muajve nga dita e mbylljes së vitit financiar, përgatit dhe i paraqet Këshillit Mbikqyrës llogaritë vjetore dhe raportet vjetore të veprimtarisë financiare të shoqërisë për t'i verifikuar dhe kontrolluar.

KAPITULLI IV KONTROLLI I SHOQËRISË

Neni 35 Ekspertët Kontabël

Asambleja e Përgjithshme emëron ekspertët kontabël të cilët kanë të drejtën të:

- Ndihmojnë në mbajtjen e llogarive me qëllim që të jenë në përputhje me parimet kryesore të kontabilitetit;
- Përgatitin raportet vjetore me të dhëna ekonomike (bilancet, llogaritë e fitimit dhe humbjeve dhe dokumente të tjera që lidhen me to) dhe japin mendimet e tyre nëse të dhënat ekonomike reflektojnë gjendjen ekonomike aktuale të shoqërisë.
- Informon Këshillin Mbikqyrës mbi çdo parregullsi të mundshme të vënë re në procedura, asetet e shoqërisë që mund të kenë shkaktuar humbje për shoqërinë.

Neni 36 Kompetencat

Ekspertët kontabël qëndrojnë në detyrë për periudhë prej 1 (një) viti.

Eksperti kontabël është i detyruar të mbikqyrë llogaritë vjetore të janë përpiluar në përputhje me ligjin "Për Kontabilitetin" dhe përmbajnë rezultatet e periudhës ushtrimore dhe japin rezultatin e plotë të vitit financiar që u mbyll. Eksperti kontabël ka kompetencat që parashikohen në ligjin e shoqërive

Nëse eksperti kontabël nuk i kryen detyrat e tij ashtu siç duhet, ai mund të pezullohet nga detyra me vendim gjyqi i cili mbledhet dhe vendos me procedurë urgjente.

Neni 37 Librat e Shoqërisë

Shoqëria duhet të mbajë librat e kërkuar nga ligji në të cilët regjistrohen llogaritë vjetore, deklaratat financiare vjetore, bilancet vjetore, raportet ekonomike vjetore të cilët duhet të përmbijnë çdo gjë që parashikohet nga ligji.



Neni 38
Viti Financiar

Viti financiar ka një kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke filluar që nga data 1 Janar deri në datën 31 Dhjetor, me përjashtim të vitit të parë i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në gjykatë dhe mbaron në 31 Dhjetor 2004.

Këshilli Mbikqyrës mbikqyr llogaritë vjetore që të jenë në përputhje me ligjin "Për Kontabilitetin" dhe harton raportin mbi administrimin.

Neni 39
Rezerva e Domosdoshme Ligjore

Rezerva e domosdoshme ligjore krijohet nga të paktën 5 për qind e fitimit neto që mbetet pas zbritjes së humjeve të viteve të kaluara. Një procedurë e tillë nuk është e detyrueshme kur fondi rezervë bëhet sa 1/10 e kapitalit aksioner.

Neni 40
Ndarja e Fitimit

Fitimi llogaritet si rezultat i fitimit të bilancit duke i zbritur rezervën e domosdoshme dhe humbjet e viteve të kaluara sipas nenit 40.

Neni 41
Dividendi

Pas miratimit të bilancit vjetor dhe llogarotjen e shumës që do të ndahet, Asambleja e Përgjithshme përcakton shumën që do tu jepet aksionerëve si dividend në bazë të neneve 215, 216 të ligjit të shoqërive.

KAPITULLI V
PRISHJA

Neni 42
Prishja

Shoqëria priset nëse ka mbruar kohëzgjatja e sj ose në rast se ka shpallur falimentimin.

Neni 43
Likuidimi

Shoqëria likuidohet në përputhje me dispozitat ligjore për falimentimin.

Shoqëria bën likuidimin në çastin e prishjes së saj për çfarëdolloj arsyeje me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 10 të ligjit të shoqërive.



Gjatë likuidimit, emri i shoqërisë ndiqet nga shprehja "në likuidim". Ky emër si dhe emri i likuidatorit duhet të pasqyrohen në të gjitha veprimet dhe dokumentet e lëshuara nga shoqëria tek të tretët.

KAPITULLI VI

Neni 44 Dispozita të Përgjithshme

Për çështjet që nuk parashikohen në këtë statut zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi për Shoqëritë Anonime pa ofertë publike.

Ky statut është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj pas marrjes së miratimit nga organet Shqiptare kompetente në bazë të ligjit shqiptar në fuqi.

AKSIONERI Trans-European Energy B.V, Sh.A

Alban Caushi




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

NR. 5162 REP.


NR. 2007 KOL.

VËRTETIM

Sot më datë 7 Dhjetor 2004 para meje A Mallkuçi, notere e Dhomës së Notereve Tiranë, u paraqit personalisht Z. Alban Caushi, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 25 Mars 1973, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër QH 328197, i cili në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë "TRANS-EUROPEAN ENERGY B.V., SH.A." me anë të vendimit të Bordit të Drejtorëve të kësaj shoqërie, date 26 Nëntor 2004, më paraqiti këtë Statut dhe pasi e nënshkroi atë rregullisht para meje, unë noterja e vërtetoj nënshkrimin e tij sipas ligjit.



NOTERE
NOTERE
ARIANA R. MALLKUÇI
Tel/Zyre 250253.266242





**PERKTHIM JOZYRTAR I
AKTIT TE THEMELIMIT**

I

Trans-European Energy B.V.

Me seli në Amsterdam

Hollandë

Datë 22 Dhjetor 2003

Emërtimi. Selia e Shoqërisë

Neni 1

Emri i shoqërisë është: Trans-European Energy B.V.

Selia e shoqërisë është në Amsterdam.

Objekti

Neni 2

Objekti i shoqërisë është:

- a. ndërtimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e impianteve të gazit dhe energjisë;
- b. ndërtimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e tubacioneve të naftës;
- c. financimi i transaksioneve të projekteve këtu;
- d. tregëtia e brendshme dhe ndërkombëtare e karburantit të çdo lloji (si nafta apo gazi), dhe energjisë;
- e. blerja ose pjesëmarrja në shoqëria që zhvillojnë aktivitetet në sektorin e gazit dhe energjisë;
- f. çdo çështje tjetër e lidhur me sektorin e gazit dhe të energjisë, si dhe pjesëmarrja, marrja e interesave në çdo mënyrë tjetër, drejtimi i administrimit të sipërmarrjeve të tjera të çfarëdolloj natyre, dhe më tej, financimi i palëve të treta, në çdo mënyrë për të siguruar mbrojtjen dhe marrjen përsipër të detyrimeve të palëve të treta dhe së fundmi të gjitha veprimtaritë e tjera të cilat mund të lidhen në mënyrë aksidentale apo si rrjedhojë e ndonjë prej këtyre të përmendura këtu.

Kapitali dhe kuotat

Neni 3

- 3.1 Kapitali i autorizuar i shoqërisë është njëqind mijë euro (100.000 Euro). Është i ndarë në një mijë (1.000) aksione me vlerë një qind (100) Euro secili.
- 3.2 Kuotat do të regjistrohen në formë dhe do të numërohen nga 1-shi në vazhdim.
- 3.3 Asnjë certifikatë aksionesh nuk do të lëshohet.
- 3.4 Shoqëria mund të japë hua me qëllim nënshkrimi apo blerje të aksioneve në kapitalin e saj fillestar deri në shumën e rezervave të shpërndashme. Një vendim nga bordi i administratorëve për dhënien e huave sipas paragrafit të mësipërm do t'i nënshtrohet aprovimit të asamblesë së përgjithme të aksionerëve, që këtu e më poshtë do të quhet: asambleja e përgjithshme.

Shoqëria do të ruajë një rezervë të pashpërndashme të barabartë me shumën e papaguar të huasë që përmendet në këtë paragraf.

Emetimi i kuotave

Neni 4

- 4.1 Kuotat do të lëshohen në përputhje me një vendim të asamblesë së përgjithshme; asambleja e përgjithshme do të përcaktojë çmimin dhe kushtet e mëtejshme të emetimit.
- 4.2 Kuotat nuk do të emetohen asnjëherë me një çmim poshtë vlerës nominale..
- 4.3 Kuotat do të emetohen me akt noterial në përputhje me dispozitat 2:196 të Kodit civil.
- 4.4 Ortakët nuk gëzojnë të drejta parablerje në lidhje me lëshimin e tyre apo të drejtës për nënshkrim..
- 4.5 Shoqëria nuk është e autorizuar të bashkëpunojë në lëshimin e certifikatave të depozitimit të kuotave.

Pagesa për kuotat

Neni 5

- 5.1 Kuotat do të jepen vetëm përkundrejt pagesës së plotë.
- 5.2 Pagesat do të bëhen në të holla, nëse nuk ka marrëveshje për blerje në ndonjë mënyrë tjetër.
- 5.3 Pagesat në të holla mund të kryhen në valutë, me miratimin e shoqërisë.

Blerja dhe depozimi i aksioneve

Neni 6

- 6.1 Me marrjen e miratimit nga asambleja e përgjithshme, bordi i drejtorëve mund të shkaktojë që shoqëria të bëjë pjesë të kapitalit të saj, një numër të konsiderueshëm kuotash të shlyera plotësisht, në mënyrë që vlera nominale totale e kuotave të kapitalit që do blihen dhe që zotërohen aktualisht nga shoqëria dhe filialet e saj të mos e kalojë gjysmën e kapitalit themeltar të emtuar dhe të mos prekë dispozitat e tjera përkatëse të seksionit 2:207 të Kodit Civil.
- 6.2 Neni 4 i paragrafit është njësoj i aplikueshëm për shitjen nga shoqëria të kuotave të kapitalit të saj fillestar. Një vendim për shitjen e këtyre kuotave presupozohet që përfshin miratimin në paragrafin 2:195 , nënparagrafi 4 i Kodit Civil.

Regjistri i aksionerëve

Neni 7

- 7.1 Bordi drejtues do mbajë regjistrin e ortakëve në përputhje me dispozitat përkatëse të statutit.
- 7.2 Bordi drejtues do vërë në dispozicion të ortakëve regjistrin, në zyrat e shoqërisë, për inspektim nga vetë ortakët.

Njoftimet për mbledhje dhe lajmërimet

Neni 8

- 8.1 Njoftimet për mbledhjen e ortakëve, do t'i dërgohen këtyre të fundit me poste të thjeshtë apo rekomande, në adresat e deklaruara në regjistrin e ortakëve.
- 8.2 Lajmërimet për bordin drejtues do të dërgohen me letër të rregullt apo të regjistruar në zyrat e shoqërisë apo adresat e gjithë drejtorëve.

Transferimi i aksioneve

Neni 9

Cdo transferim i aksioneve do të bëhet me akt noterial, në përputhje me dispozitat e seksionit 2:196 të Kodit Civil.

Kufizime për transferimin e kuotave

Neni 10

- 10.1 Një transferim i aksioneve të shoqërisë, me përjashtim të shitjes nga shoqëria të aksioneve të cilat i ka acquire në kapitalin e vet fillestar, mund të kryhet sipas paragrafëve 2 deri në 7, përfshirë këtë të fundit, të këtij neni.
- 10.2 Ortaku, që dëshiron të transferojë një ose më shumë kuota, duhet të marrë miratimin e asamblesë së përgjithshme.
- 10.3 Transferimi, duhet të kryhet brenda tre muajve pas miratimit apo kur konsiderohet i miratuar nga asambleja e përgjithshme.
- 10.4 Miratimi do konsiderohet i dhënë nga asambleja në të njëjtën kohë kur ai refuzohet nëse asambleja nuk i paraqet ortakut që bën kërkesën për transferim, emrat e një apo më shumë palëve të interesuara, të cilat janë të gatshme të blejnë të gjitha aksionet e përmendura në kërkesën për miratim, kundrejt pagesës në të holla, me çmimin e vendosur sipas paragrafit 5; vetë shoqëria konsiderohet palë e interesuar kur ortakut i cili bën kërkesën për transferim jep miratimin.
Miratimi, do konsiderohet i dhënë nga asambleja e përgjithshme, nëse kjo e fundit nuk merr asnjë vendim në lidhje me kërkesën për miratim, brenda 6 javëve pas marrjes së saj.
- 10.5 Ortaku që paraqet kërkesën dhe palët e interesuara të pranuar nga ai, do përcaktojnë çmimin e blerjes sipas paragrafit 4, në bazë të një marrëveshje të përbashkët.
Në rastin kur nuk arrihet një marrëveshje, çmimi i blerjes do përcaktohet nga një ekspert i pavarur, i cili caktohet me marrëveshje midis bordit drejtues dhe ortakut që bën kërkesën.
- 10.6 Në qoftë se bordi i drejtorëve dhe ortakut që bën kërkesën nuk bien dakord në lidhje me caktimin e një eksperti të pavarur, ai do caktohet nga Presidenti i Dhomës së Tregëtisë dhe Industrisë, i cili është personi i autorizuar për regjistrimin e shoqërisë në regjistrin tregëtar.
- 10.7 Me përcaktimin e çmimit të blerjes nga eksperti i pavarur, ortakut që bën kërkesën është i lirë që brenda një periudhe një mujore pas përcaktimit të çmimit të blerjes, të vendosë nëse t'ia transferojë kuotat e tij palëve të interesuara të cilave iu janë caktuar.
Nëse nuk ka drejtor personi i përmendur në fjalinë paraardhëse do marrë masat e nevojshme sa më shpejt e mundur për të arritur në një marrëveshje përfundimtare

Administrimi

Neni 11

- 11.1 Shoqëria do administrohet nga një bord drejtorësh, i përbërë nga një drejtor A dhe dy drejtorë B.
- 11.2 Një person juridik mund të caktohet si drejtor.
- 11.3 Drejtorët do caktohen nga asambleja e përgjithshme. Asambleja e përgjithshme, mund të perzullojë apo shkarkojë drejtorët, në cdo kohë.
- 11.4 Asambleja e përgjithshme do përcaktojë kushtet dhe afatet e punësimit të drejtorëve.
- 11.5 Në rast se një apo më shumë nga drejtorët ndalohet të veprojë apo dështon në kryerjen e veprimeve, drejtorët e tjerë do mbulojnë përkohësisht detyrën e tij. Në rast se të gjithë drejtorët apo vetëm një drejtor ndalohet/en të veprojë/në apo dështojë/në së kryeri një veprim, personi i caktuar ose që do caktohet për këtë qëllim nga asambleja, do marrë përsipër përkohësisht administrimin.

Vendimet e bordit të drejtorëve

Neni 12

- 12.1 Në bazë të dispozitave të këtij statuti, bordi i drejtorëve mund të nxjerrë rregulla për rregullimin e veprimtarisë së tij të brëndshme. Përveç kësaj, drejtorët nëpërmjet rregullave apo mënyrave të tjera, mund të ndajnë detyrat midis tyre.
- 12.2 Bordi i drejtorëve do mblidhet sa herë që e kërkon njëri nga drejtorët. Bordi i drejtorëve i merr vendimet me shumicë absolute të votave të vlefshme. Në rastin e një votimi të barabartë, vendos asambleja e përgjithshme.
- 12.3 Bordi i drejtorëve mund të marrë vendime dhe në mungesë mbledhjeje, me kusht që këto vendime të merren me shkrim, me kablogram, telex, telefax, dhe që të gjithë drejtorët të jenë shprehur në favor të marrjes së këtij vendimi.
- 12.4 Bordi i drejtorëve, duhet t'i përmbahet udhëzimeve të asamblesë së përgjithshme në lidhje me politikat e përgjithshme të financimit, ato sociale, ekonomike dhe të personelit të cilat duhet të ndihen nga shoqëria.
- 12.5 Asambleja e përgjithshme mund të nxjerrë vendime, sipas të cilave theksohet qartë se, bordi i drejtues duhet të marrë më parë miratimin e asamblesë për të marrë vendime.

Përfaqësimi. Përfaqësuesit e autorizuar.

Neni 13

- 13.1 Bordi i drejtorëve është i autorizuar të përfaqësojë shoqërinë. Shoqëria mundet të përfaqësohet gjithashtu nga një drejtor A dhe një drejtor B, të cilët veprojnë bashkarisht.
- 13.2 Nëse një drejtor që vepron në cilësi personale lidh marrëveshje me shoqërinë, ose, nëqoftë se ai, duke vepruar në cilësinë personale, ngre padi kundër shoqërisë, shoqëria, mund të përfaqësohet në këtë çështje, në përputhje me paragrafin 1, nga drejtorët e tjerë, me përjashtim të rastit kur asambleja e përgjithshme cakton një person për këtë qëllim ose ligji parashikon ndryshe. Ky person, mund të jetë gjithashtu drejtori me të cilin ka konflikt interesash.

- Nëse një drejtor ka konflikt interesash me shoqërinë, i ndryshëm nga ai sipërpërmendur në fjalinë e parë të këtij paragrafi, ai, si çdo drejtor tjetër i shoqërisë, ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë, në përputhje me dispozitat e këtij paragrafi.
- 13.3 Bordi i drejtorëve mund t'i japë një apo më shumë personave, të punësuar ose jo nga shoqëria, të drejtën e përfaqësimit të shoqërisë ("me prokurë") ose t'i japë në një mënyrë tjetër të drejtën e përfaqësimit të shoqërisë në mënyrë të vazhdueshme. Bordi i drejtorëve mund t'i japë këto të drejta personave të përmendur në fjalinë e mëparshme si dhe personave të tjerë, por vetëm nëse ata janë të punësuar nga shoqëria.

Mbledhjet e përgjithshme

Neni 14.

- 14.1 Mbledhja e përgjithshme vjetore do mbahet brenda gjashtë muajve pas përfundimit të vitit financiar.
- 14.2 Rendi i ditës i mbledhjes do përfshijë në çdo rast miratimin e llogarive vjetore, shpërndarjen e fitimeve dhe përjashtimin e drejtorëve nga përgjegjësia e administrimit të tyre gjatë vitit të fundit financiar, me përjashtim rastit kur periudha për përgatitjen e llogarive vjetore është zgjatur.
- Në mbledhjen e përgjithshme, çdo pikë tjetër që i është shtuar rendit të ditës në përputhje me paragrafët 5 dhe 6 të këtij neni, do diskutohet.
- 14.3 Mbledhja e përgjithshme do mblidhet sa herë që bordi i drejtorëve ose një ortak e konsideron të arsyeshme.
- 14.4 Mbledhjet e përgjithshme do të mbahen në vendin ku ndodhet selia e shoqërisë. Vendimet që, merren nga mbledhja e përgjithshme mbajtur në vend tjetër, janë të vlefshme vetëm në rast se përfaqësohet i gjithë kapitali i shlyer.
- 14.5 Ortakët njoftohen për mbledhjen e përgjithshme nga bordi i drejtorëve, nga një drejtor ose nga një ortak. Njoftimi duhet të përcaktojë pikat për diskutim.
- 14.6 Njoftimi, do jepet jo më vonë se ditën e pesëmbëdhjetë, para datës së mbledhjes. Nëse periudha e njoftimit ka qenë më e shkurtër ose nuk është dërguar, nuk mund të miratohen vendime të vlefshme përveç rastit kur miratohen me unanimitet nga mbledhja, në të cilën i gjithë kapitali i shlyer është i përfaqësuar.
- Sa më sipër, do zbatohet në mënyrë të njëjtë për çështje, të cilat nuk janë përmendur në njoftimin e mbledhjes ose në një njoftim shtesë dërguar në përputhje me afatet e njoftimit.
- 14.7 Mbledhja e përgjithshme do caktojë kryetarin e saj. Kryetari do caktojë sekretarin.
- 14.8 Procesverbali do mbahet nga transkriptimi i mbledhjes.

Të drejtat e votës së ortakëve.

Neni 15.

- 15.1 Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.
- Të drejtat e votës bashkangjitur kuotave nuk mund t'i akordohen mbajtësve të të drejtës së uzufuktit dhe mbajtësve të së drejtës së pengut mbi këto kuota.
- Drejtorët si të tillë kanë vetëm të drejtë votë këshilluese në mbledhjet e përgjithshme.
- 15.2 Ortakët mund të përfaqësohen në mbledhje nga një person i pajisur me prokurë.
- 15.3 Vendimet miratohen nga një shumicë absolute të votave të vlefshme.
- 15.4 Ortakët mund të miratojnë çdo vendim, i cili miratohet në mbledhje, pa qenë nevoja që të thirret kjo e fundit. Drejtorëve u jepet e drejta për të këshilluar lidhur me këto

vendime, përveç kur është e papranueshme sipas kriterit të arsyes dhe drejtësisë për të dhënë një mundësi të tillë.

Një vendim, që merret pa u mbajtur mbledhja, është i vlefshëm nëse të gjithë ortakët me të drejtë vote i kanë dhënë votat e tyre me shkrim, në mënyrë kabllore, me teleks ose telefaks në favor të propozimit përkatës.

Ortakët do njoftojnë menjëherë bordin e drejtorëve për vendimin e marrë.

Viti financiar. Llogaritë vjetore

Neni 16.

- 16.1. Viti financiar do koïncidojë me vitin kalendarik
- 16.2. Çdo vit, brenda pesë muajve pas përfundit të çdo viti financiar, - me përjashtim kur kjo periudhë zgjatet maksimumi gjashtë muajsh, nga mbledhja e përgjithshme për shkak të rrethanave të veçanta – bordi i drejtorëve përgatit llogaritë vjetore dhe ia vë dispozicion për kontroll otakëve në zyrën e shoqërisë. Llogarive vjetore do i bashkangjitet vërtetimi i auditorit, përmendur në nenin 17, nëse janë dhënë udhëzimet e përmendura në këtë nen do i bashkangjitet raporti vjetor, përveç kur seksioni 2:391 i Kodit Civil nuk zbatohet për shoqërinë, dhe nga informacioni shtesë përmendur në seksionin 2:392 nënseksioni 1 i Kodit Civil, për sa kohë që dispozitat e këtj nënseksioni zbatohen për shoqërinë.
- 16.3. Llogaritë vjetore do nënshkruhen nga të gjithë drejtorët. Nëse mungon firma e një ose më shumë drejtorëve, kjo do bëhet e ditur duke deklaruar arsyet.

Auditori.

Neni 17.

Shoqëria mund të udhëzojë një auditor, siç përmendet në seksionin 2:393 të Kodit Civil, që të kontrollojë llogaritë vjetore të përgatitura nga bordi i drejtorëve në përputhje me nënseksionin 3 të seksionit 2:393, nëse ligji parashikon që shoqëria duhet të japë udhëzime të tilla. Nëse ligji nuk kërkon që të jepen udhëzimet e përmendura në fjalinë e mësipërme, shoqëria mund të udhëzojë një ekspert tjetër që të kontrollojë llogaritë vjetore të përgatitura nga bordi i drejtorëve; ky ekspert që këtu e tutje do quhet auditor.

Mbledhja e përgjithshme autorizohet të japë udhëzimet e sipërpërmendura. Nëse mbledhja e përgjithshme nuk i jep këto udhëzime, në lidhje me këtë autorizohet bordi i drejtorëve.

Udhëzimet që i jepen auditorit revokohen në çdo kohë nga mbledhja e përgjithshme ose nga bordi i drejtorëve nëse ky i fundit jep këto.

Auditori do t'i raportojë bordit të drejtorëve dhe lëshon një vërtetim që përmban rezultatet e kontrollit.

Fitimet dhe humbjet.

Neni 18.

- 18.1 Shpërndarja e fitimeve në përputhje me këtë nen do bëhet pas miratimit të llogarive vjetore të cilat tregojnë se shpërndarja lejohet.
- 18.2 Fitimet do jenë në dispozicion të plotë të mbledhjes së përgjithshme.
- 18.3 Shoqëria mund t'i shpërndarje ortakëve dhe personave të tjerë që kanë të drejtë për të shpërndarë fitime, vetëm në masën që kuotat e ortakëve të saj të mos kalojnë shumën e kapitalit të emtuar dhe rezervat që mbahen sipas ligjit.
- 18.4 Humbja merret nga rezervat që mbahen sipas kërkesës së ligjit vetëm deri në masën e lejuar prej tij.

18.5 Kur shpërndahet shuma midis ortakëve, kuotat e zotëruara nga shoqëria nuk do të merren parasysh.

Shpërndarja e fitimeve.

Neni 19.

- 19.1 Dividentët janë të pagueshëm katër javë pasi janë deklaruar, përveç kur mbledhja e përgjithshme vendos një datë tjetër sipas propozimit të bordit të drejtorëve.
- 19.2 Mbledhja e përgjithshme mund të vendosë që dividendët të shpërndahen plotësisht ose pjesërisht në një formë tjetër nga ajo në të holla.
- 19.3 Sipas nenit 18 paragrafi 3, mbledhja e përgjithshme mund të vendosë të shpërndajë të gjithë ose një pjesë të rezervave.
